



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Prill, 2022

Kongresi i 8-të, një ngjarje e veçantë e SBASHK-ut



Nënkryetarja Vjollca Shala, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror dhe me vullnetarë sindikalë me përkushtim kishin bërë angazhime të jashtëzakonshme që kjo ngjarje e veçantë të ketë rrjedhë të mbarë. Një angazhim i veçantë ishte bërë që mysafirët e nderuar të priteshin ashtu ...(faqe 4)

Dy takime të rëndësishme të Kryesisë Ekzekutive të BSPK-së

Bashkë jemi zë më i fuqishëm sindikal

Protesta e 8 prillit ka dëshmuar ...(faqe 10)

Intervistë me nënkryetaren e SBASHK-ut Vjollca Shala

Besimi i dhënë obligim për të vazhduar me angazhimet në shërbim të anëtarësisë



Vjollca Shala në katër vitet e kaluara ...(faqe 3)

Takimi i parë i Këshillit të ri Drejtues të SBASHK-ut

Unitet i plotë në marrje të vendimeve konkrete



Në afatin e paraparë me Statutin ...(faqe 9)

SBASHK me federatat tjera sindikale në protestën e 8 prillit

Forcohet uniteti në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës



Duke respektuar vendimin ...(faqe 7)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Krenaria për besimin e ruajtur



Njeriu kalon nëpër sfida të shumta të jetës dhe ka një ideal e një arsye të veçantë që të jetojë e të mbetet i fort kundër furtunave të kohës. Një vlerë që njeriu duhet bërë çmos e ta ruaj është besimi që krijojnë të tjetër për ty. Është ndjenjë krenarie kur njerëzit shprehin se këtij i besojmë se është i fjalës dhe i besës. Mirëpo, kjo vlerë duhet ruajtur edhe kur kalon njeriu nëpër sfida e situata nga më të vështirat. Kongresi i SBASHK-ut ma shtoi krenarinë duke parë gjithë atë unitet mes delegateve e delegatëve. Mysafirët e lartë nga Brukseli e vende të tjera ndjenin këtë unitet dhe atmosferën solemne në këtë

ngjarje të veçantë dhe ishte krenari kur ata na përgëzonin për arritjet dhe për organizimin e shkëlqyer të Kongresit e për këtë kanë merita Vjollca, Ymeri, Afërdita, Blendi, Nezi, Vlora, Albina dhe shumë nga veprimtarët vullnetare. U ndjeva krenar edhe me rastin e votimit për kryetar.

Delegatet e delegatët e thanë fjalën e tyre përmes votës së fshehtë duke përcjellë zërin e mijëra anëtarëve të SBASHK-ut, që nga çerdhet, Arsimi Parauniversitar, Universitetet dhe kultura. Krenari për besimin që duhet ruajtur me çdo kusht e pavarësisht sfidave që do të sjell koha. Me unitet e me besimin e ndërsjellë do të vazhdojmë edhe sot e gjithmonë. Bashkë e në SBASHK.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me nënkryetaren e SBASHK-ut Vjollca Shala

Besimi i dhënë obligim për të vazhduar me angazhimet në shërbim të anëtarësisë



Vjollca Shala në katër vitet e kaluara në cilësinë e nënkryetares së SBASHK-ut u dëshmuua me punë, përkushtim e angazhim në mbrojtjen e

kërkesave të anëtarësisë kudo në takimet me institucionet lokale e qendrore. Ajo përfaqësoi me sukses SBASHK-un edhe në shumë takime ndërkombëtare sindikale. Kjo ka bërë që Vjollca të krijoj besim dhe respekt meritore te anëtarësia dhe dëshmi e kësaj është rizgjedhja për nënkryetare me votat e gjithë anëtarëve të Këshillit Drejtues. Vjollca për gazetën tonë "Arsimimi sot" flet për angazhimet në të ardhmen për të vazhduar që të jetë zë i anëtarësisë.

Arsimimi sot

Si ndjeheni tani pas rizgjedhjes suaj nga Këshilli Drejtues për nënkryetare të SBASHK-ut?

Vjollca:

Ndjehem krenare me besimin e dhënë nga koleget e kolegët e mi. Ky për mua është obligim për të vazhduar me angazhimet maksimale në shërbim të anëtarësisë. Më vjen mirë që më është vlerësuar angazhimi dhe përpjekjet që kam bërë bashkë me kryetarin Jasharaj, koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, me stafin qendror, por edhe me Kryesinë dhe kryetarët e nivelit komunal e të Universiteteve në realizimin e kërkesave të anëtarësisë dhe për të qenë kudo zë i fuqishëm i tyre. Kështu do të vazhdoj edhe në të ardhmen.

Arsimimi sot

Si e shihni SBASHK-un e këtyre viteve?

Vjollca:

Të gjithë bashkë jemi angazhuar dhe kemi dhënë kontribut që të realizojmë kërkesat e anëtarësisë duke realizuar kështu shumë nga objektivat. Këto vite ishin me plot sfida dhe nuk e kishim të lehtë në angazhime, por, ishte uniteti në SBASHK që na dha forcë dhe janë shënuar edhe arritje të shumta. Pra SBASHK-u vazhdoi të mbetet kujdestar në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave sublimë dhe në vazhdimësi do të kontribuojmë pa rezervë në realizimin e kërkesave të drejta të punonjësve të arsimit. Më gëzon fakti se kemi krijuar besim të ndërsjellë dhe është shtuar dukshëm numri i femrave veprimtare sindikaliste. Këtë përkushtim dhe përvojat tona në shërbim të një sindikalizmi të organizuar mirë e kemi bartur edhe te sindikatat tjera në Kosovë me të cilat kemi bashkëpunim në kuadër të BSPK-së.

Arsimimi sot

Në cilat çështje mendoni se duhet fokusuar angazhimet më shumë në të ardhmen?

Vjollca:

Duhet të fokusohemi edhe në të ardhmen për të dhënë përgjigje meritore se cila është pozita momentale e punëtorëve arsimor, cilat janë kushtet e punës në institucionet arsimore, cili është dhe cili do të jetë statusi i mësimdhënësit, cili është raporti punëdhënës-punëmarrës dhe çështje e sfida të tjera që i sjell koha në të ardhmen. Do të vazhdojmë kontributin tonë edhe në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve, në të cilën sferë kemi dhënë kontribut të lartë duke organizuar trajnime të licencuara me mijëra kolegë tanë, gjithnjë duke iu ndihmuar në fitimin e njohurive të reja e që ndikojnë në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim. Në partneritet me MASHTI-in do të punojmë në hapjen e drejtimeve të reja në shkollat profesionale, drejtime këto që janë të kërkuara në tregun e ri të punës. Do të angazhohemi bashkë e të gjithë edhe në realizimin e kërkesave të anëtarësisë.

Gjatë muajit

Kongresi i 8-të, një ngjarje e veçantë e SBASHK-ut

Dëshmi e unitetit dhe udhërrëfyes për aktivitetet e radhës

Nënkryetarja Vjollca Shala, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror dhe me vullnetarë sindikalë me përkushtim kishin bërë angazhime të jashtëzakonshme që kjo ngjarje e veçantë të ketë rrjedhë të mbarë. Një angazhim i veçantë ishte bërë që mysafirët e nderuar të priteshin ashtu si e thotë tradita jonë e mikpritjes.



Të shtunë e 2 prillit koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin kishin shkuar në ambientet e Fakultetit të edukimit për të parë edhe një herë se mos është harruar ndonjë detaj pa u kryer si duhet. Çdo gjë ishte në vendin e duhur dhe Kongresi nisi me pjesën solemne të punimeve. SBASHK me punë e angazhim ka krijuar respekt meritor edhe të Internacionalja e Arsimit, të Komiteti i Sindikatave të Arsimit të Evropës, por edhe të sindikatave simotra nga shtetet e ndryshme dhe kjo u dëshmuar edhe me pjesëmarrjen e tyre në Kongres.



Ishin në këtë ngjarje të rëndësishme dhe me fjalët përshëndetëse shprehen gjithë respektin, por edhe përkrahjen për angazhimet e SBASHK-ut Drejtorja e Komitetit Evropian të Sindikatave për Arsim Susan

Flocken, mikja e madhe të SBASHK-ut Trudy Kerperien, që është anëtare e Bordit qendror të EI-së, nënkryetare e ETUCE dhe sekretare për marrëdhënie me jashtë të Sindikatës së Arsimit të Holandës, drejtori i Programit të Qendrës së Solidaritetit me bazë në SHBA Steven McCloud, Kryetari i sindikatës së Arsimit të Turqisë Ali Yalçın, Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Arsimit nga Shqipëria Nevruz Kaptelli, kryetari i Federatës Sindikale të Arsimit dhe Shkencës nga Shqipëria Isa Rekaj, Kryetari i Sindikatës së Arsimit të Maqedonisë së Veriut kolegu i nderuar Jakim Nedelkov, Kryetari i Sindikatës së Arsimit nga Mali i Zi Radomir Bozhoviq, Kryetari i Sindikatës së Arsimit nga Qiproja turke Ozan Elmali, përfaqësuesi nga Presheva, Bujanovci dhe Medvegja profesori i nderuar Agim Hasani, Rektori i nderuar Artan Nimani, Kryetari i Odës së Hotelerisë dhe turizmit të Kosovës Hysen Sogojeva, Kryetari i Këshillit të Prindërve të Komunës së Prishtinës Jeton Demi, Kryetari e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës Blerim Syla dhe kryetari i BSPK-së Atdhe Hykolli.

Delegatëve dhe mysafirëve me një fjalë rasti u është drejtuar edhe ministrja e MASHTI-t ,znj. Arbërie Nagavci.



Duke shpallur fillimin e pjesës solemne të Kongresit kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka shprehur respekt të lartë për unitetin e shkëlqyer të gjithë

anëtarësisë e pastaj me një fjalim emocional ka kujtuar koleget e kolegët që pandemia duke u bërë mik i ngushtë me vdekjen i mori duke na krijuar zbrazëti e dhembje të madhe.



Pas kësaj kryetari Jasharaj duke folur për arritjet dhe angazhimet e SBASHK-ut në të ardhmen u ka deklaruar delegatëve se nuk bën shumë plane të angazhimit në letër sepse plani i veprimit e angazhimit të SBASHK-ut janë kërkesat dhe zëri i anëtarësisë. “Covid u bë shok i ngushtë me vdekjen dhe ua ndërpreu rrugëtimin në misionin e shenjtë shumë kolegeve e kolegëve tanë. Lajmet që ata më nuk janë mes nesh na pikëlluan vazhdimisht dhe edhe sot e gjithmonë do ta ruajmë e lartësojmë kujtimin për ta”, u shpreh plot emocione kryetari Jasharaj teksa në ekran shfaqeshin fotografitë e kolegeve e kolegëve tanë që nuk janë më mes nesh.



I penguar që të jetë në Kongres nga angazhimet e shumta dhe situatat e reja të krijuara në shumë sindikata kudo në Evropë e botë, sekretari i përgjithshëm i EI-së, David Edwards i është drejtuar pjesëmarrësve me një mesazh përmbajtësor e domethënës nga larg duke ripërsëritur përkrahjen e Internacionales së Arsimit për SBASHK-un në përpjekjet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë.



Pas kësaj Drejtorja e Komitetit Evropian të Sindikatave për Arsim znj. Susan Flocken i është drejtuar Kongresit duke i ka bërë të qartë Ministres Nagavci se të 11 milionë anëtarët e Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës ishin dhe janë me sindikatën anëtare SBASHK dhe e mbështesin në të gjitha angazhimet në shërbim të anëtarësisë. Ajo ka përsëritur se Qeveria ka obligim të zhvillojë dialog të mirëfilltë me SBASHK-un dhe të realizojë kërkesat legjitime.



Mikja e madhe e SBASHK-ut Trudy Kerperien, që është anëtare e Bordit qendror të EI-së, nënkryetare e ETUCE dhe sekretare për marrëdhënie me jashtë e Sindikatës së Arsimit të Holandës ka kujtuar bashkëpunimin me SBASHK-un nëpër vite e dekada duke shprehur gëzimin për arritjet e shumta që ka shënuar kjo sindikatë. Me fjalë përshëndetëse e duke vlerësuar lart angazhimin, përkushtimin dhe arritjet e SBASHK-ut i janë drejtuar Kongresit edhe të gjithë kryetarët e sindikatave simotra nga shtete të ndryshme, që ishin pjesë e kësaj ngjarje të veçantë.



SBASHK duke vlerësuar lart angazhimin dhe mbështetjen e vazhdueshme morale për gjithë sindikatat në botë e në veçanti edhe ndaj SBASHK-ut ka nderuar me titullin më të lartë Honoris Causa Fehmi Agani sekretarin e përgjithshëm të Internacionales së Arsimit David Eduards, Drejtoren e Komitetit Evropian të Sindikatave për Arsim Susan Flocken dhe koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri për kontribut të lartë në gjithë angazhimet dhe aktivitetet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë.



Në pjesën e dytë të punimeve Kongresi ka aprovuar raportet e punës dhe atë financiar e të Komisionit mbikëqyrës. Delegatët e kanë aprovuar me votën e tyre edhe Planifikimin buxhetor për 4 vitet e ardhshme.



Në vazhdim të punimeve delegatët janë njoftuar nga Komisioni Kandidues për propozimet e arritura për kryetar të SBASHK-ut dhe për Komisionet gjegjëse.



Delegatët me votën e tyre të fshehtë e në garën mes dy e më shumë kandidatëve kanë zgjedhur edhe për një mandat Rrahman Jasharajn për kryetar të SBASHK-ut e po ashtu kanë votuar e zgjedhur edhe tre anëtarë të Komisionit mbikëqyrës dhe të Komisionit statutor.



SBASHK falënderon dekanin e stafin dhe të punësuarit në Fakultetin e Edukimit për përkrahjen për mbajtjen me sukses të Kongresit.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

SBASHK me federatat tjera sindikale në protestën e 8 prillit

Forcohet uniteti në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës



Duke respektuar vendimin Kongresit të 8-të e duke parë se Qeveria Kurti vazhdon me hezitimin për të pasur dialog me sindikatat e për t'u angazhuar në zgjidhjen e kërkesave të tyre legjitime, SBASHK-u ka paraqitur idenë në mbledhjen e Kryesisë Ekzekutive të BSPK-së që të ketë veprime sindikale e duke përmendur 8 prillin. Kryesia Ekzekutive ka mbështetur këtë ide dhe është marrë vendim unanim që në shenjë reagimi ndaj heshtjes së Qeverisë të organizohet protestë me pjesëmarrjen e vetëm kryetarëve e kryesive të shoqatave sindikale dhe të organeve udhëheqëse të secilës federatë.



Më 8 prill pjesëmarrësit e protestës janë takuar fillimisht te Biblioteka Kombëtare e pastaj në mënyrë të organizuar kanë filluar marshimin nëpër rrugët e kryeqytetit për të arritur pastaj para ndërtesës së



Qeverisë. Policia e Kosovës gjatë gjithë kohës së marshimit, por edhe sa ka zgjatur protesta, ka treguar pedanteri e sjellje shembullore në krye të detyrës së tyre e për këtë i kanë ndihmuar me sjellje dinjitoze edhe pjesëmarrësit e këtij veprimi sindikal.

Kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli para ndërtesës së Qeverisë e në prani të shumë medieve ka shpalosur kërkesat duke insistuar edhe një herë që Qeveria të nis me dialogun përmbajtësor dhe të angazhohet sinjerisht për zgjidhjen e kërkesave legjitime e të drejta të të punësuarve në tërë sektorin publik. Ai ka nënvizuar veçmas kërkesën që Ligji i pagave në pajtueshmëri me sindikatat të miratohet sa më parë e deri në implementimin e tij Qeveria të bëjë rritje të pagave prej 100 euro për të gjithë të punësuarit që marrin paga nga buxheti i Kosovës.





Kryetari Hykolli ka kujtuar edhe kërkesën që të nis së implementuari Ligji i sigurimeve shëndetësore dhe që të bëhet plotësim ndryshimi i Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti e që sidomos të ndryshohet neni 8, paragrafi 1 e nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 në mënyrë që të hiqet kriteri diskriminues që për të marrë pensionin e punës i punësuari me rastin e pensionimit duhet të ketë 15 vite kontributdhënëse para datës 1 janar 1999, kriter ky i pamundshëm për t'u arritur kur dihet se pushteti i dhunshëm i instaluar serb në ato vite kishte larguar nga puna mijëra punëtorë të Kosovës.

Nga aktivitetet e Këshillit Shtetëror të Licencimit të Mësimdhënësve **Angazhim për të qenë sa më afër punëtorëve arsimor**

Këshilli Shtetëror i Licencimit të Mësimdhënësve, i kryesuar nga kryetari prof. Osman Beka është duke bërë angazhime për t'i dhënë përgjigje meritore shumë pyetjeve që ndërlidhën me licencimin, por edhe me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve arsimor. Në kuadër të këtyre përpjekjeve është organizuar tryezë dyditore me gjithë anëtarët e Këshillit Shtetëror të Licencimit. Është debatuar shtruar lidhur me procesin e licencimit, gjegjësisht licencave për punëtorët e arsimit, për vlerësimin e përfundancës, zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Në këtë tryezë ka marrë pjesë edhe kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, që është anëtarë i KSHLM-së, cili është angazhuar që të përgatiten Udhëzime Administrative e dokumente tjera, që janë në shërbim të punëtorëve arsimor. Ai është shprehur se mësimdhënësit meritojnë respekt të lartë dhe meritojnë të ndihmohen e këshillohen në misionin e tyre të shenjtë për edukimin e brezave.



Në këtë protestë Qeverisë i është drejtuar edhe kryetari i Këshillit Drejtues të BSPK-së, Ali Gashi, por edhe kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj.” Nëse Qeveria vazhdon me heshtjen, sindikatat do të vazhdojnë me veprimet sindikale. Pas 20 prillit do të ketë edhe greva edhe protesta. Dikujt nuk do t'i dalin hesapet si duhet, e asaj që nuk do t'i dalin hesapet si duhet do të jetë Qeveria”, ishte shprehur Jasharaj në protestën e 8 prillit.



Edhe kryetari i Këshillit Shtetëror të Licencimit të Mësimdhënësve ka kujtuar, edhe një herë, se duhet çmuar e vlerësuar angazhimin e punëtorëve arsimor dhe se ata duhen mbështetur e ndihmuar karshi sfidave të shumta të kohës. Anëtarët e KSHLM-së janë të bindur se me angazhimin e propozimet konkrete të tyre do të krijohet mundësi që Ministria Nagavci dhe kabineti i saj bazuar në këto këshilla të përgatis Udhëzime gjegjëse për çështjet e ngritura e të debatuar gjatë këtij takimi dyditor të KSHLM-së.

Takimi i parë i Këshillit të ri Drejtues të SBASHK-ut

Unitet i plotë në marrje të vendimeve konkrete

Në afatin e paraparë me Statutin e SBASHK-ut është bërë konstituimi i Këshillit të ri Drejtues, i cili ka mbajtur takimin e parë në përbërje të re për të analizuar situatën aktuale e për të marrë vendime brenda kompetencave që ka.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj në fjalën përshëndetëse ka përgëzuar anëtarët e Këshillit Drejtues duke u kujtuar se janë pjesë e organit më të lartë të SBASHK-ut mes dy Kongreseve dhe se i presin shumë angazhime në përpjekjet për të realizuar kërkesat e anëtarësisë në këtë kohë plot sfida.



Pas konstituimit të Këshillit Drejtues, kryetari Jasharaj i ka dorëzuar shkresën Komisionit kandidues duke u bazuar në pikën 22 të nenit 69 të Statutit të SBASHK-ut që ka të bëjë me zgjedhjen e nënkryetares. Komisioni ka vlerësuar se kandidatja Vjollca Shala plotëson gjithë kriteret e kërkuara nga Statuti.



Vjollca Shala ka prezantuar para pjesëmarrësve programin e punës për katër vitet e ardhshme dhe pas kësaj anëtarët e Këshillit Drejtues me votën e lirë e të fshehtë i kanë dhënë besimin edhe për një mandat koleges Shala që të jetë nënkryetare e SBASHK-ut.



Pas kësaj anëtarët e Këshillit Drejtues kanë dëgjuar informatat e kryetarit Jasharaj, nënkryetares Shala dhe koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri lidhur me situatën aktuale dhe për angazhimet që janë bërë në kuadër të BSPK-së që të ketë dialog me institucionet dhe që të gjendet zgjedhje për kërkesat aktuale të anëtarësisë. Është theksuar se ka pasur takime e komunikim, porse kjo është vlerësuar e pamjaftueshme dhe prandaj në takimin e Kryesisë Ekzekutive të BSPK-së sindikatat anëtare janë pajtuar që të ketë edhe veprime sindikale duke saktësuar se më datën 12 maj tërë sektori i arsimit, por edhe sektorët tjerë publik do të mbajnë grevë njëorëshe, ndërsa më 20 maj, nëse deri atëherë nuk ka lëvizje e marrëveshje konkrete, atëherë do të organizohet një protestë me pjesëmarrjen e gjithë anëtarësisë.

Dy takime të rëndësishme të Kryesisë Ekzekutive të BSPK-së

Bashkë jemi zë më i fuqishëm sindikal

Protesta e 8 prillit ka dëshmuar se kur sindikatat angazhohen bashkërisht në aktivitete sindikale, atëherë zëri sindikal bëhet më i fuqishëm. Kjo u tha edhe në takimin e jashtëzakonshëm të kryesisë Ekzekutive të BSPK-së, më 20 prill, kur u bë vlerësim i protestës dhe u debatua lidhur me aktualitetin e krijuar pas saj. Kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli ka lavdëruar SBASHK-un dhe Federatat tjera për pjesëmarrjen e dinjitetshme në protestën e 8 prillit e pastaj ka informuar lidhur me përmbajtjen e takimit që ai bashkë me anëtarin e Kryesisë Ekzekutive, gjegjësisht nënkryetaren e SBASHK-ut, Vjollca Shala, kishin me kryeministrin Kurti. Në atë takim, sipas përfaqësuesve të BSPK-së, është bashkëbiseduar për të gjitha kërkesat e anëtarësisë dhe shpresohet se Kurti dhe Qeveria do të vazhdojmë me takimet dhe me angazhimet për gjetjen e zgjidhjeve të pranueshme për kërkesat e prezantuara qartë në atë takim.

Anëtarët e Kryesisë Ekzekutive theksuan se u mbetet të shpresojnë se Qeveria do të vazhdojë dialogun e nisur më në fund dhe u pajtuan që të mbahet më 28 prill mbledhja e radhës e Kryesisë Ekzekutive për të analizuar se çfarë ka ndodhur brenda javës. Kështu edhe ndodhi. Më 28 prill në selinë e BSPK-së janë takuar prapë anëtarët e Kryesisë Ekzekutive dhe



Këshilli Drejtues i SBASHK-ut në këtë takim mori vendim që të fillohet me përgatitjet për realizimin e aktivitetit tradicional për dërgimin e një numri të konsiderueshëm të anëtareve e anëtarëve të SBASHK-ut për pushime në bregdetin shqiptar duke rikujtuar edhe kriteret që duhen respektuar nga shoqatat sindikale gjatë përzgjedhjes së pushuesve.

bashkërisht kanë analizuar aktualitetin. Ata kanë dëgjuar nga kryetari Hykolli se ka vazhduar komunikimi me anëtarë të stafit qeveritar, porse takime me Ministrat nuk ka pasur ende, porse ka premtime se këto do të ndodhin së shpejti. Kryesia Ekzekutive është shprehur se kjo nuk është e mjaftueshme dhe prandaj kanë sjellë vendim unanim që më 12 maj të organizohet grevë njëorëshe në sektorët që përfaqësojnë sindikatat anëtare të BSPK-së dhe nëse edhe pas këtij paralajmërimi nuk ka reflektim të duhur të Qeverisë, do të organizohet protestë më 20 maj duke ftuar gjithë anëtarësinë që të jetë pjesë e këtij reagimi sindikal. Sindikatat anëtare të BSPK-së janë pajtuar që në vazhdimësi të gjithë angazhimet dhe veprimet sindikale t'i marrin bashkërisht sepse bashkë, siç u tha në këto takime, jemi zë më i fuqishëm sindikal.

